

normave të moralit të përgjithshëm shoqëror dhe i ka dhënë liri të plotë shprehjes së vet poetike. Tekefundit, tradita e këngëve të dashurisë është ruajtur brez pas brezi, prandaj në çdo kohë gjeneratat më të vjetra e kanë toleruar këngën e këtillë të të rinjve, duke konsideruar si ekzistencë të pavarur poetike që ka bukurinë dhe kënaqësinë e vet jashtë realitetit të përditshëm.

Në bazë të zgjedhjes që kanë bërë përpiluesit e blenit „*Këngë dashurie I*”, Rrutem Berisha dhe Myzafere Mustafa, këngët e dashurisë me elemente sensualiste dhe shpërthime të pasioneve erotike, në asnjë rast nuk arrijnë në kufij të banalitetit. Ata kanë vepruar drejt kur, siç thuhet në parathënie „*nuk i kanë bërë censurë dukurisë sensuale-natyraliste*”, që është e pranishme në një numër këngësh, sepse në kushtet e sotme, kur njeriu ynë është liruar nga shumë paragjykime të moralit të së kaluarës, këngët e këtilla, që në radhë të parë janë me interes për studimin e letërsisë popullore, lexohen me ëndje edhe nga lexuesit e ndryshëm. Tekefundit, këto këngë si pjesë e traditës së vetë poetike, vetë populli i ka çmuar dhe i ka ruajtur si vlera të krijimtarisë së tij shpirtërore.

Në blenin „*Këngë dashurie I*” disa nga këngët i kanë edhe nga dy-tri variante. Botimi i varianteve, sidomos kur ato janë shënuar në treva mjaft të largëta nga njëra-tjetra, paraqet interes të veçantë për studimin e letërsisë popullore, sepse nëpërmjet tyre dalin më të plota vlerat artistike të këngëve, vërehet shtrirja e tyre territoriale, mënyra e zhvillimit evolutiv dhe e krijimit të strukturës poetike të këngëve, si edhe karakteristikat e tjera lidhur me unifikimin e koncepteve estetike të interpretuesve dhe të dëgjuesve të këngës popullore në vise të ndryshme. Qëndrimi i drejtë i

përpiluesve të blenit lidhur me variantet që përmbajnë vlera poetike, jo vetëm që duhet të ruhet edhe për vëllimin e dytë të këngëve të dashurisë, i cili parashihet të botohet në të ardhshmen, por konsiderojmë se në këtë vëllim duhet të botohen edhe variantet e reja që janë shënuar më vonë të këngëve nga vëllimi i parë. Në këtë mënyrë lexuesve, e sidomos studiuesve të ardhshëm, do t'u kompletohej lënda shumë e pasur folklorike dhe do t'u prezentohejshin të gjitha vlerat poetike që përmban poezia popullore shqiptare e dashurisë.

Libri „*Këngë dashurie I*” është pajisur edhe me një fjalorth fjalësh të rralla dhe shprehjesh të ndryshme arkaike e krahinore, i cili ka kryesisht qëllim praktik. Poezia popullore e dashurisë që është paraqitur në këtë ble dëshmon edhe për pasurinë gjuhësore të folklorit tonë. Me interes të veçantë janë sidomos disa kompozita, që kanë funksione të veçanta poetike, të cilat nuk i gjejmë fare në gjuhën letrare shqipe. Përveç fjalorthit, vepra është pajisur edhe me shënime të nevojshme për interpretuesit dhe mbledhësit e këngëve.

Duke marrë parasysh, në radhë të parë, vlerën poetike të krijimeve popullore, punën e përpiluesve për zgjedhjen e mbarështrimin e lëndës, parathënien e shkruar me përkushtim, në fund mund të pohojmë se libri „*Këngë dashurie I*” është botim i rëndësishëm i Institutit Albanologjik të Prishtinës dhe do të shërbejë si bazë për studimin e suksesshëm të lirikës popullore shqiptare. Një botim i këtillë është me interes të përgjithshëm për kulturën tonë shpirtërore. Këtij interesi padyshim i ka kontribuar edhe puna e Dr. Shefqet Pllanës në redaktimin e këtij vëllimi.

SADRI FETIU

**Biserka Rajčić (përkthyes), RELIGIOZNI OBREDI, OBIČAJI I SIMBOLI, Beograd 1980, f. 411.**

Për mitologjinë, në kuadrin e etnologjisë, sidomos viteve të fundit, është duke u shfaqur një interesim i madh në planin hulumtues dhe studiues, nga dijetarë të këtij lëmi. Një përpjekje të tillë e paraqet edhe li-

bri për të cilin e kemi fjalën: *Zakone, ceremoni dhe simbole religjioze*, shkruar nga një grup autorësh, e i përkthyer nga Biserka Rajčić. Hartuar nga shtatë autorë, në këtë libër trajtohen doke, zakone e ceromoni

rituale e magjike të popujve nga shumë vende të botës, duke filluar nga Hindija, Kina, Japonia, Lindja e Afërme, Judizmi, Evropa e Vjetër, Krishterimi, Islamizmi, e duke përfunduar me një analizë të hulumtimeve mbi rëndësinë shoqërore të miteve, simboleve dhe ritualeve. Pra, rëndësia e këtij libri nuk qëndron vetëm në faktin se janë trajtuar probleme nga kultura shpirtërore e popujve të ndryshëm të botës, porse përballë atyre shtresimeve substratike të religjionit primitiv-popullor, i cili ka zënë rrënjë që nga paganizmi, problemi shikohet edhe në planin e ndikimeve të reja, të konfesionëve fetare më të vona, të cilat ushtruan ndikim mbi religjionin popullor të çdo populli dhe kulture të tij.

Librit i paraprin një hyrje, e shkruar nga Juzef Keleri, ku me pak fjalë sqaron kuptimin e simboleve, të cilat i përdorin jo vetëm religjionet por edhe të gjitha fushat e tjera në kulturë, si psh: në shkencë, filozofi, art, në jetën nacionale e shoqërore. Shkurtazi, autori, bën fjalë pastaj për *simbolikën religjioze*, për *llojlojshmërinë e simboleve religjioze* (simbolikën formale dhe atë reale). Pa pretendime se do t'i ketë përfshirë të gjitha simbolet, autori këto i grupon në tri lloje kryesore: 1. Simbolet e gjuhës në të cilat i radhit: a) *mitet dhe legjendat*, mbi ca ngjarje, të cilat kinse se kanë ndodhur në të kaluarën e lashtë (kryesisht në parahistori); b) *disa fjalë*, si bie fjala „babë”, „nënë”, të aplikuar në funksionin simbolik për hyjnitë e që nuk kanë domethënien e prindërve në jetën e zakonshme c) „*rrëfimet fetare*”, të cilat paraqesin formula verbale që zakonisht përveçtesohen nga pjesëtarët e fesë përkatëse. 2. *Veprimet rreth kulteve*, të cilat i konsideron si tok simbolesh e shenjash në veprimet ceremoniale religjioze, dhe 3. *Simbolet artificiale*: fotografitë e ndryshme, vizatimet, skulpturat e shenja të tjera që paraqesin forma sakrale në kuptimin më të ngushtë. Të gjitha këto bëjnë pjesë në grupin e simboleve formale. Duke bërë fjalë për simbolet e ndryshme religjioze, të trajtuara si reale, flet për: 1. *simbolikën qiellore*, duke konsideruar qiellin si „të shenjtë”, 2. *simbolikën lunare*, si shumë të pasur në religjionin e la-

shtë, porahistorik; 3. *simbolikën akvatike (të ujërave)*, të cilën e konsideron si shumë të rëndësishme në të gjitha religjionet gjer më sot, e cila me fuqinë e vet (të ujit) magjike, shëron sëmundje, gjer sa në ritualin funeral siguron rijetësim pas vdekjes; 4. *simbolizmin e tokës, bujqësisë dhe pjellshmërisë*, të cilat janë zhvilluar dhe përhapur në kohën e zhvillimit të bujqësisë dhe të blegtorisë në të gjitha religjionet botërore.

Tadeush Zhbikovski, në vazhdim, në studimin e vet, bën fjalë për zakonet, ceremonitë dhe simbolet në religjionin indus dhe kinez. Pas një hyrjeje të shkurtër, në të cilën na pasqyrohet një lëvizje migruese në këto troje aziatike, përkatësisht një përzierje kulturore e nacionale, e cila krijon një konglomerat ndikimesh reciproke në të gjitha sferat e jetës, e në radhë të parë të religjionit popullor, në mënyrë të shkoqitur flet për shumë çështje nga kjo fushë. Së pari bëhet fjalë për besimet dhe ceremonitë e arijevasve, pastaj për besimet e tyre në jetën e amshueshme, ceremonitë e varrimit, për zakonet rreth djegies së grave veja, për shpirtat dhe demonet, për trijadën e madhe hinduiste, për kultin e hyjnive, etj.

Kështu, në vazhdim, autori vazhdon studimin e tij për Kinën, vendin me kulturë më të lashtë në lindjen e largët. Pas hyrjes, studimin e fillon me „pikënisjen”, përkatësisht „metodën”, ose „mënyrën” TAO, në të cilën gjendet gjithësia si rrugë e pambarim. Bëhet fjalë për In-jang, si dy elemente të personifikuara me gjini të kundërta: *jangu* i gjinisë mashkullore, i cili karakterizohet me aktivitet, dritësi dhe nxehtësi dhe *in-a* e gjinisë femërore që simbolizon pasivitetin, errësirën dhe ftohtësinë. Në vazhdim flitet për *kalendarin, astrologjinë, geomantinë, hierarkinë shoqërore, etikecinë, lindjen e foshnjeve, martesën, ceremonitë e varrimit, kafshët e demonet dhe, më në fund, për kultin e qiellit.*

Për ceremonitë, zakonet dhe simbolet religjioze në Japoni, flet, në artikullin e vet, në vazhdim të këtij libri, Vjeslav Kotanjski. Problemet në fjalë, vijnë e bëhen edhe më interesante, më të rëndësishme dhe kureshtare, kur kihet parasysh fakti se është fjala për një vend me më te-

për se 931 organizata religjioze të ndara në grupe fetare: shintoiste, budiste, krishtere dhe grupe të tjera me ceremoni rituale të ndryshme (sipas regjistrimit të vitit 1965).

Problemi i parë që trajton autori janë: kultet dhe institucionalizimi i tyre, ose prej magjie gjer te metafizika.

Pjesëmarrja individuale, përkatësisht e personalitetit, dhe grupet shoqërore në aktet kulte ose japonezi dhe perënditë, është kaptina e veçantë e këtij studimi. Në vazhdim, bëhet fjalë për hapësirën e shenjtë ku japonezi e sheh praninë e perëndive, për të vazhduar me trajtimin e çështjeve rreth kohës së shenjtë dhe integritetit të shenjtë, ose prej nismës në mbarim.

Në punimin e Vitold Tilohut: zakonet, ceremonitë dhe simbolet religjioze në Judizëm dhe në Lindjen e Afërme, bën fjalë për: zotat, kultin e tyre, për cikluset religjioze vjetore dhe kremtet e tyre, për religjionin dhe jetën e njeriut, të gjitha këto në kuadër të Lindjes së Afërme.

Festat e Judizmit, Pasha (festë kalendarike pranverore që festohet me rastin e solsticit veror e që i kushtohet kulaçit të bukës) e cila ruan një traditë nga zakonet më të lashta të bujqve dhe të blegtorëve, përkatësisht që paraqet një simbiozë të këtyre dy veprimtarive ekonomike në traditën zakonore, janë tema të veçanta që trajtohen në këtë punim. Në vazhdim autori trajton festat e së dielës-Shevuot; festat koliba-Sukot, kremte vjeshtore në religjionin judist; Ditën e pajtimit-Jon kipur; Vitin e ri-Rosh hashana; festën Hanuke festë që kremtohet tetë ditë në muajin nëntor-dhjetor, e që ka për qëllim rikujtimin e altarëve për sjelljen e një krijese flijuese nga ana e makabejve, i cili e profanoi Antiohin IV Epifan në vitin 165. p.e.s.), Festen Purima; Sabat; Ditët e ninimit; ceremonitë religjioze në jetën e njeriut; Bar micvan; bashkëshortësinë; shkurorëzimin, ceremonitë rituale të të vdekurit; simbolet religjioze (ullin e Davidit), etj.

Vlodimjezh Shafranjski, në punimin e tij, studion zakonet, ceremonitë dhe simbolet religjioze në Evropën e Vjetër.

Derisa shkenca etnologjike oscilon rreth hipotezës se kur ka filluar të

zëjë rrënjë religjioni popullor, përkatësisht cilat janë format initiale të tij dhe, derisa format tashmë të njohura si elemente të religjionit primitiv: fetishizmi dhe manaizmi ose magjia dhe totemizmi, qarkullojnë në pjesën e rrugës, të larguara dukshëm nga pika zero e religjionit fillestar, autori në fjalë, i bazuar në të arriturat e shkencës arkeologjike, këtë pikënisje e shef në fascinimin e njeriut me dukurinë e parë të jetës dhe të vdeksjes, i bazuar në burimet arkeologjike të paleolitit të ri. Këto probleme autori i ka shtruar në pjesën e parë të studimit të tij me titull: Dëshira troglodite për pavdekshmëri. Pjesë e veçantë e këtij studimi është tema: Në burimet e fesës në pashkët, për të vazhduar më tej në temën tjetër: „Fërkemeve të zotit”, pastaj në: fshehtësia lakonike është deshifruar. „Prototipi” evropian i Krishtit mbret, Pan Tvardovski në Hënë; enigma nëndetare e urneve „facijale” dhe në fund: Mosmarrëveshja me Svetovidin, paraqet tema të rrahura në këtë studim, në të cilat ndriçohen probleme të mitologjisë, riteve e ceremonive rituale, të paraqitura nëpërmjet simbolesh të ndryshme, në religjionin e Evropës së vjetër.

Pa përcaktuar trevë, për problemet e shkoqitura në të gjitha kaptinat e këtij libri, flet edhe Juzef Keleri, por duke vështruar problemin brenda krishterimit si konfesion fetar, shumë i përhapur në mbarë botën.

Autori në fjalë, në këtë kaptinë trajton disa tema si: religjionizimin popullor, në botën e çudirave, problemin e së keqes, religjionizimin oficijel-dogmatizmin, etapat e viteve të kishës dhe etapat e jetës së njeriut.

Për religjionin, përkatësisht simbolet, zakonet dhe ceremonitë religjioze, brenda islamizmit, në kaptinë e parafundit, shkruan Edvard Shimanjski. Këtë problematikë autori në fjalë e ka shkoqitur në disa tema, ku bën fjalë për: dogmatizmin mysliman, botimin e librit, obligimet qenësore të myslimanit, lindjen e foshnjeve, krijimin e bashkëshortësisë, shkurorëzimin, vdekjen, besimin në jetën e pasmortsme dhe për amuletet dhe hajmalitë.

Libri përmbillet me studimin: Humlumtimet mbi rëndësinë shoqërore të miteve, simboleve dhe ritualeve.

Çështjet e shtruara në këtë libër, nuk bëjnë fjalë drejtpërdrejt për besimet. Ky libër nuk është as pasqyrë oficijele e doktrinave religjioze e as e atyre liturgjike; por në të bëhet fjalë për simbolikën, ceremonitë dhe zakonet religjioze të religjioneve dhe të popujve të ndryshëm të botës.

Zakonet religjioze dhe ceremonitë, për të cilat bëhet fjalë këtu, janë shprehje e religjionit popullor, i cili mund të haset në të gjitha religjionet e mëdha, më së shpeshti i maskuar me forma të ndryshme të kultit oficijel, thotë Juzef Keleri. Ceremonitë dhe zakonet që i ushtron populli, shpeshherë nuk janë në pajtim me rregullat e religjionit oficijel, brenda së cilës aplikohen, sikundër që nuk janë të njëjta ndryshimet në mes të kultit popullor dhe oficijel. Kështu, bie fjala, ngjet me religjionet e Lindjes së largët, të cilat janë tolerante ndaj besimeve të tjera dhe lejojnë

që i njëjti njeri të rrëfëhet njëkohësisht në disa religjione.

Gjersa në religjionet „dogmatike”, siç është judaizmi, krishterimi dhe islamizmi, shmangiet nga principet oficijele trajtohen si shmangie nga feja si përçarje.

Shkurt, ky libër, dëshmon për faktin se religjioni nuk është vetëm aq sa kuptohet në qarqet e teologëve. Dëshmon për faktin se religjionet janë terren ku krijohen paragjykime nga më të ndryshmet, johumane, veprime të ashpra, të cilat shpeshherë konsiderohen si obligime religjioze.

Sidoqoftë, rëndësia e këtij libri, në fushën e etnologjisë, përkatësisht mitologjisë, është e madhe. Aq më parë, nga se trajtimi i problematikës zakonore, ceremoniale dhe simbolike kap një areal të gjerë të shtrirjes në disa kontinente, popuj, konfesione fetare e religjioze. Prej këtu, pra, ofrohet mundësia për një studim komparativ.

UKE XHEMAJ

#### **Anton Çetta, KËRKIME FOLKLORIKE, botoi Rilindja, Prishtinë, 1981.**

Libri *Kërkime folklorike*, bashkë me parathënie ka nëntëmbëdhjetë punime dhe është i ndarë në dy kapituj kryesorë: *Nga proza popullore* dhe *Nga poezia popullore*.

Në punim *Për një ndarje më të plotë të prozës popullore dhe emërtimin e ca llojeve të saj* A. Çetta, autor me formimin filologjik, që në krye të librit *Kërkime folklorike*, shqyrton problemin e klasifikimit të letërsisë gojore në përgjithësi, nga mund të mësohet për orientimin teorik të autorit dhe ku tregohet prija për trajtime analitike bashkëkohore, pa lënë as mënyrën tradicionale të qasjes se problemeve të letërsisë gojore.

Në këtë trajtesë autori shtron edhe çështjen e periodizimit, respektivisht domosdonë e thellimit dhe të plotësisht me emërtime të reja të disa llojeve të prozës. Në fillim autori thekson nevojën e ngutshme të klasifikimit të letërsisë gojore, duke marrë parasysh faktin se letërsia „artistike” (e shkruar) përcaktohet dhe kushtëzohet nga letërsia gojore dhe se stu-

dimi i së parës ndihmon studimin më sistematik të së dytës. Problemet e njërës janë të lidhura ngushtë me ato të të dytës dhe autori është i bindur për vlerat e mëdha kulturore të materialeve folklorike kur ato futen në procesin e arsimit të të rinjve. Prandaj, shqyrtimi i çështjes së periodizimit dhe i emërtimit më të plotë simbas llojeve dhe nënlojeve është i rëndësishëm për shumë arsye. Mbi të gjitha del i nevojshëm saktësimi dhe rishqyrtimi i termave.

Duke nisur nga këto këndshikime teorike, A. Çetta bëri mbledhjen e folklorit ndër vise të ndryshme të Kosovës dhe hodhi hullinë e parë dhe të thellë të shpjegimit dhe interpretimit të letërsisë gojore, që padyshim shërben si inicim për studime të specializuara të krijimeve të gjithfarshme gojore. Ndihmesa e A. Çettës është e madhe sidomos në saktësimin terminologjik sikundër është e tillë edhe në trajtimin e secilës çështje, me të cilën merret ky autor.

Këto punime të A. Çettës për çështje të caktuara, as tash nuk kanë